



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI

Nr. 869 prot.

Tiranë, më 11.03.2020

VENDIM

Nr. 5, datë 09.03.2020

**PËR
NDËRPRERJEN E PROCESIT MËSIMOR NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,
TIRANË**

Bazuar në nenin 3, 40 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe këkrimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 31 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Urdhrin e Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 91, datë 09.03.2020 “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike”, si dhe në Urdhrin e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 135, datë 09.03.2020 “Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së COVID-19”, Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në mbledhjen e tij të datës 09.03.2020,

VENDOSI:

1. Ndërprerjen e procesit mësimor dhe aktivitetëve me pjesëmarrje masive në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë deri në një njoftim të dytë.
2. Njësitë bazë të UMT-së, të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim funksionimin administrativ të tyre.
3. Ngarkohen njësitë kryesore të UMT-së për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**REKTORI
ARBEN GJATA**

